



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE KAMËZ

Nr. 1389 prot.

Kamëz, më 14/08/2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr.759, dt.30.09.2024, i ndryshuar me Udhëzimin nr.4, datë. 18.08.2025 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ”,

Ofruesi publik i AFP-së, **Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz**, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1 specialist këshillues me kohë të plotë, me afat të pa përcaktuar.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në praktikën e këshillimit dhe orientimit, mundësisht për të rritur;
- b) njohuri për politikën publike dhe orientimet kryesore strategjike në fushën e arsimit dhe formimit për të rritur/të nxënësit gjatë gjithë jetës;
- c) nivel të kënaqshëm njohurish për kuadrin ligjor të njohjes, si dhe për të drejtat dhe detyrat e kandidatëve, plus trajnimin fillestar;
- ç) diplomë “Bachelor” – niveli 6 i KSHK-së në shkencat shoqërore, ose në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore ose fusha të ngjashme

2.Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në);

c) kartën e identitetit;

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës 27.08.2026

3.Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759,datë27.05.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ", i ndryshuar .

DREJTOR
Ornela LALA

